



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:053216
Datë: 27.05.2019
Numri i dokumentit: 00330506

P.nr.1439/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Fidan Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional Shqipron Sedolli, në çështjen penale ndaj të akuzuarit G.K nga, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.1988-10/18 të datës 13.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, nën prezencën e prokurorit të shtetit Naim Gashi, dhe të akuzuarit, me datë 15.05.2019, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 24.05.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G. K, nga i ati Sh. dhe ëma Sh. e lindur B., i lindur më datë, banon në ..., në rrugën “...” pa.nr., i martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion fasader, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal:, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 28.05.2018, në në shtëpinë e tij familjare, e cila gjendet në rrugën “.....” pa.nr, gjatë një kontrolli të bërë nga ekipi i kompanisë “....” rezulton se i pandehuri me qëllim që të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme nga shërbimi komunal, shfrytëzon energjinë elektrike në mënyre indirekte, përmes një faze e cila nuk ka matur fare energjinë elektrike të shpenzuar, duke anashkaluar njehsorin elektrik nr..... me nr. Unik të konsumatorit :, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar “....” distrikti në ...i ka shkaktuar dëm material.

Me këto veprime ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 8, 9, 10, 47, 48, 69, 70 dhe neni 314 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton dënimin dhe atë:

DËNIM ME KUSHT

- dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1(një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar ...- distrikti në, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1988-10/18 të datës 13.09.2018, ndaj të akuzuarit G.K nga për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 KPRK-së.

Gjykata duke pasur parasysh se me datën 14.04.2019, ka hyrë në fuqi KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, duke u bazuar në neni 3 të këtij kodi e ka aplikuar si ligj penal më të favorshëm për të akuzuarin duke pasur parasysh se me këtë kod parashihet vepra penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314, për të cilën vepër penale parashikohet edhe mundësia për shqiptim të dënimit alternativ si dënim me gjobë ose me burgim përderisa me Kodin Penal paraprak parashihej mundësia për shqiptimin e dënimit kumulativ si dënim me gjobë dhe me burgim, andaj gjykata ka vlerësuar se zbatimi i Kodit më të Ri Penal i datës 14.04.2019 është më i favorshëm për të akuzuarin në rastin konkret.

Gjykata në këtë çështje penale e ka caktuar shqyrtimin fillestar në të cilin i akuzuari pasi që është deklaruar lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1988-10/18, të datës 13.09.2018, ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas kësaj aktakuze.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale nga shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se me datë 28.05.2018, në, në shtëpinë e tij familjare, e cila gjendet në rrugën “...” pa.nr, gjatë një kontrolli të bërë nga ekipi i kompanisë “...” rezulton se i pandehuri me qëllim që të përfitojë në mënyrë të kundërligjshme nga shërbimi komunal, shfrytëzon energjinë elektrike në mënyre indirekte, përmes një faze e cila nuk ka matur fare energjinë elektrike të shpenzuar, duke anashkaluar njehsorin elektrik nr....., me nr. Unik të konsumatorit : ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç ‘rast ndërmarrjes së dëmtuar “...” distrikti në i ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit G.K në shqyrtimin fillestar, i cili ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilat akuzohet. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa

pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tij. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit dhe se me këtë dënim të tillë të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se në të ardhmen dënimin i tillë i shqiptuar do të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në pajtim me nenin 453 par.1. të KPPK.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 463 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:053216, 24.05.2019

G j y q t a r i

Fidan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.